



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2197, datë 23.11.2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të Repartit Ushtarak 1040 dhe Repartit Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.11.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të Repartit Ushtarak 1040 dhe Repartit Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”, të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 88, neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “*Portabilitetin e numrit*” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.1219, datë 07.04.2010, ndryshuar me VKD nr. 1530, dt. 18.3.2011, ndryshuar me VKD nr. 1776, dt 20.2.2012 (*Rregullore nr. 13*).
4. Rregullore nr. 18 “*Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*)”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”.
- Shkresa e Vodafone Albania sh.a. me ref. LGD/0252/EL, datë 31.8.2012 “*Dërgohen prapësimet e Vodafone Albania në lidhje me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012*”.
- Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1654 Prot, datë 3.9.2012 (nr. 1594/5Prot., datë 4.9.2012) “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtura nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.*”.
- Korrespondenca e shkëmbyer me postë elektronike (email) si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

AKEP me anë të Vendimit nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes si më lart përmendur, midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.,” në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:

- Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.
- Të njoftohen palët e interesuara Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
- Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit”;

- I. Vodafone Albania sh.a., me shkresën me ref. LGD/0252/EL, datë 31.8.2012 (nr. 1594/4Prot.i AKEP, datë 3.9.21012) ka dërguar prapësimet në lidhje me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012, dhe sqaron se:

Vodafone, ka vepruar në përputhshmëri të plotë me ligjin nr. 9918 dhe rregulloren përgjatë gjithë veprimtarisë së saj në marrëdhënien me Eagle Mobile dhe se ka respektuar rigorozisht çdo afat dhe detyrim ligjor që sanksionohet nga kjo bazë ligjore.

Vodafone garanton se respekton parimet e portabilitetit dhe se ka vepruar në përputhje të plotë me rregulloren sa i takon pajtimtarëve: Reparteve Ushtarake 1040 dhe 1050.

- Në kuptim të këtij procedimi Vodafone shprehet se nga ana procedurale Eagle Mobile nuk legjitimohet për të ngritur pretendime në lidhje me vlefshmërine apo afatin e mbarimit të kontratës së pajtimit midis Vodafone dhe pajtimtarëve të Vodafone, pasi pretendime të tilla mund të ngrihen nga palët kontraktore, duke ndjekur rrugët përkatëse ligjore sipas procedurave të parashikuara nga Kodi Civil dhe Kodi i Procedures Civile.
- Vodafone sqaron se ka zgjidhur kontratat e pajtimtarit me Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050 më datë 12.7.2012, në përputhje të plotë me “Kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për pajtimtarin – Kontrata Tip e Pajtimtarit. Nga Vodafone janë respektuar të gjitha afatet e parashikuara për njoftimin e pajtimtarit sipas nenit 14 – Ndërprerja/Shkëputja e Kontratës së Pajtitimit.

i. Pajtimtarëve të Rep. Ushtarake 1040 dhe 1050, u janë dërguar njoftime të vazhdueshme me SMS lidhur me detyrimet e krijuara duke i paralajmëruar edhe për pasojat përkatëse deri në ndërprerjen e shërbimit, gjatë gjithë periudhës së gjendjes debitoare. SMS i fundit është dërguar me datë 20.4.2012, për pajtimtarin Rep. Ushtarak 1040 dhe me datë 24.4.2012 dhe datë 4.5.2012, për pajtimtarin Rep. Usht. 1050, përkatësisht 192, 196 dhe 206 ditë pas kalimit të afatit të përcaktuar për kryerjen e pagesës sipas nenit 14/d, të kontratës.

ii. Ndërprerja e pjesshme e shërbimit (bllokimi i thirrjeve hyrëse) është bërë për numrat e pajtimtarëve që nuk kanë kryer pagesat në datat 24-25 Prill 2012 për Rep. Ushtarak 1040

dhe datat 26 Prill dhe 7 Maj 2012 për Rep. Ushtarak 1050, në përputhje me nenin 14/e të kontratës.

iii. Më datë 7.7.2012 është dërguar letra zyrtare për zgjidhjen e kontratës së pajtimit me pajtimtarët Rep. Ushtarak 1040 dhe 1050, pas kalimit të afatit prej dy muajsh nga ndërprerja e perkohëshme në përputhje me nenin 15/i të kontratës.

Sa më sipër, Vodafone u ka lënë pajtimtarëve një periudhë kohore të mjaftueshme prej 9 muaj (270 ditë) përtej të gjitha afateve ligjore të përcaktuara në Kontratën e Pajtitimit për të kryer pagesat përkatëse, të cilat ende nuk janë kryer nga pajtimtarët, dhe Vodafone po ndjek procedurat e mëtejshme ligjore në lidhje me rekuperimin e detyrimeve të palikujduara.

- Sipas nenit 15/b, të kontratës së pajtitimit parashikohet se “Vodafone mund të zgjidhe menjëherë kontratën pa patur detyrim dëmshpërblimi duke njoftuar me shkrim pajtimtarin kur ky i fundit nuk paguan menjëherë detyrimet pas kalimit të afatit prej 2 muajsh nga ndërprerja e perkohshme ose bllokim i rrjetit duke njoftuar atë me shkrim.

Vodafone sqaron se, sikurse mund të konstatohet lehtësisht që nga momenti i ndërprerjes së perkohshme të shërbimeve (datat 24-25 prill 2012) deri në momentin e zgjidhjes së kontratës (12 prill 2012) kanë kaluar me shumë se 2 muaj. Pra provohet se Vodafone ka përmbushur të gjithë detyrimin kontraktor për zgjidhjen e kontratës së pajtitimit.

- Neni 15, përcakton qartësisht se në përfundim të periudhës 2 mujore nga ndërprerja e shërbimit, Vodafone ka të drejtën ligjore ta zgjidhë menjëherë Kontratën e Pajtitimit. Pretendimi i Eagle Mobile se është shkelur afati kontraktor 5 ditor për njoftimin paraprak të pajtimtarit është i pabazuar. Një afat i tillë 5 ditor nuk parashikohet në kontratën e pajtitimit (neni 15) nga Vodafone. Ky është një afat diskrecional që Vodafone mund t’u lërë pajtimtarëve për të inkurajuar kryerjen e pagesës, por nuk është afat i detyrueshëm në bazë kontraktore për Vodafone, për më tepër kur pajtimtarit i është lënë një afat duke filluar nga 24-25 prill 2012 për të shlyer detyrimet kundrejt Vodafone. Sipas nenit 15, parashikohet kusht i vetëm për përfundimin e menjëhershëm të kontratës vetëm me kalimin e afatit 2 mujor që nga momenti i ndërprerjes së perkohshme ose bllokimit të rrjetit deri në momentin e përfundimit të kontratës së pajtitimit, kusht i cili sikurse provuam me lart rezulton të jetë i përmbushur nga Vodafone.

Vodafone, thekson se Eagle Mobile nuk legjitimohet si për të ngritur pretendime juridike nëse Vodafone e ka zgjidhur apo jo kontratën me pajtimtarin në përputhje me ligjin, pasi këto pretendime mund t’i ngrejë vetëm pala tjetër kontraktore, sipas K.C. dhe K.Pr.C.

- Vodafone shpjegon se kontrata është nënshkruar mes Vodafone dhe pajtimtarëve (Rep. Ushtarak 1040 dhe 1050) përfundimi është i vlefshëm për të gjithë numrat e regjistruar nën këtë kontratë pajtimi. Të gjithë numrat e secilit prej pajtimtarëve të mësipërm janë çaktivizuar përgjithmonë nga sistemet e Vodafone me datë 12.7.2012. Sipas rregullores neni 5, paragrafi 4, neni 15 paragrafi 2, c) cc) “...operatori dhënës mund të refuzojë kërkesën për bartje për ato numra që nuk janë subjekt i një kontrate aktive”.
- Në përputhje me rregulloren neni 13/4/a, pajtimtari mund të kërkojë të anulojë kontratën me operatorin dhënës pjesërisht ose tërësisht. Për këtë arsye, për një kërkesë portabiliteti do të konsiderohen vetëm numrat e pajtimtarit që paraqiten në kërkesën e operatorit

marrës për bartje, dhe jo e gjithë baza e numrave për një pajtimtar. Operatori dhënës nuk vihet në dijeni nëse pajtimtari ka bërë kërkesën pranë operatorit marrës për të gjithë numrat e një kontrate pajtimi apo për një pjesë të tyre. Në bazë të këtij rregulli, përjashtim nga përfundimi i Kontratës së Pajtimit më datë 12.7.2012, është bërë për ata numra të këtyre pajtimtarëve që kanë qenë subjekt i një kërkesë për bartje para datës 12.7.2012.

Për këtë arsye kërkesa nr. P201207110188 nuk është refuzuar me arsyen e përfundimit të kontratës, por është refuzuar për arsye se NIPT-i i dhënë nga Eagle Mobile në kërkesën e tij për bartje nuk është i njëjtë me NIPT-in e regjistruar në bazën e të dhënave të Vodafone. Theksojmë se, kjo kërkesë ka mbërritur në sistemin e Vodafone në datë 12.7.2012, por para se të fillonte procesi i çaktivizimit të numrave për këtë pajtimtar.

Vodafone shpjegon se, NIPT-i i dhënë nga Eagle Mobile në kërkesën për bartje ka qenë “K51725021B”, ndërkohë që ky pajtimtar është regjistruar në bazën e të dhënave të Vodafone me NIPT “K41930008E”. Ky i fundit është NIPT-i saktë i pajtimtarit të regjistruar në Vodafone në momentin e nëshkrimit të kontratës, sipas vërtetimit nr. 134Prot., të paraqitur nga Rep. Ushtarak 1040 dhe vërtetimit nr. 36Prot., datë 30.7.2012, të Rep. Ushtarak 1050. Çdo ndryshim i të dhënave (si NIPT) bëhet me kërkesë të pajtimtarit. Sapo është korrigjuar gabimi nga Eagle Mobile, Vodafone i është përgjigjur me kryerjen me sukses të portimit për këta numra.

- Kërkesa me nr. P201207120245, për bartje të numrave të Rep. Ushtarak 1050, është refuzuar pasi është dërguar nga Eagle Mobile me datë 12.7.2012 dhe marrë nga Vodafone me datë 13.7.2012, kohë kur kontrata me këtë pajtimtar ishte zgjidhur.
- Përsa i përket numrave të pajtimtarit Rep. Ushtarak 1001, nuk është objekt i kësaj ankese. Vodafone ka lidhur kontrata të veçanta pajtimi me secilin nga repartet 1040 dhe 150, dhe pavarësisht se këto reparte mund të bëjnë pjesë në Rep. Ushtarak 1001, në lidhje me Vodafone këta dy reparte përbëjnë pajtimtarë të veçantë. Siç edhe u përmend më lart, pajtimtari mund të kërkojë të anulojë kontratën me operatorin dhënës pjesërisht ose tërësisht. Një kërkesë portabiliteti do të konsiderohet vetëm për numrat e pajtimtarit që paraqiten në kërkesën e operatorit marrës për bartje. Duke mos qenë në dijeni nëse pajtimtari ka bërë kërkesën pranë operatorit marrës për të gjithë numrat e një kontrate pajtimi apo për një pjesë të tyre, operatorin dhënës mund të vazhdojë të procedojë me kontratën e pajtimit me pajtimtarit për ato numra që mbulohen nga kjo kontratë në përputhje me ligjin nr. 9918, dhe kushtet e përgjithshme të kontratës.

Vodafone sqaron se në asnjë moment nuk ka ndërprerë procesin e portabilitetit por ka vepruar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka zbatuar procesin e portabilitetit sipas kërkesave për bartje që ka marrë nga Eagle Mobile.

Në mbështetje të sa më sipër cituar, Vodafone ka depozituar provat bashkëngjitur kësaj praktike: kopje të kontratave me Rep. Ushtarake 1040 dhe 1050, komunikime të formës elektronike mes palëve Vodafone dhe Eagle Mobile, njoftime etj.

Në përfundim, Vodafone Albania sh.a. thekson përpara AKEP dhe palës ankimuese Eagle Mobile sh.a., se Vodafone vepron në përputhje të plotë me Rregulloren dhe ligjin nr. 9918, duke garantuar mbarëvajtjen e procesit. Sa më sipër provuar, pretendimet e

Eagle Mobile për shkelje të Rregullores nga Vodafone janë të pabazuara, të pavërteta dhe të pambështetura në ligj e në prova. Vodafone deklaron se duke qenë se të gjitha veprimet kanë qenë të bazuara në ligj, në kuadrin rregullator dhe kontratën e nënshkruar mes Vodafone dhe pajtimtarëve të tij, Vodafone nuk i ka shkaktuar asnjë dëm Eagle Mobile apo pajtimtarëve të përfshirë në proces.

Mbështetur në sa më sipër, dhe bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 99, 100 e në vijim Vodafone Albania sh.a. kërkon rrëzimin e ankimit administrativ të Eagle Mobile sh.a., dhe mbylljen e procedimit administrativ.

II. Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1654 Prot, datë 3.9.2012 (nr. 1594/5Prot., datë 4.9.2012) “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mabajtura nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”, sqaron se:

1. Eagle Mobile i është refuzuar Portimi i numrave, kjo është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Portabilitetit të numrit. E njëjta kërkesë është refuzuar fillimisht më datë 11.07.2012 për “Name and surname of subscriber does not match” apo “NIPT does not match” dhe më pas në datë 12.07.2012 me arsye “Number not located in donor network”.

Në momentin që ka filluar portimi për këta numra, ata kanë qenë aktiv në rrjetin Vodafone, për këtë arsye në zbatim të Rregullores së Portabilitetit, Neni 4 pika 3, Neni 5 pika 5, Vodafone ka qenë i detyruar të eksportonte numrin pavarisht detyrimeve kontraktore të cilat ekzistonin para bartjes.

Vodafone pretendon se ka përfunduar zyrtarisht kontratën e pajtimtarit me Repartin Ushtarak 1040, bazuar në “Kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimit të telefonisë celulare” (kontrata e Pajtimtarit) përpara kërkesës për portim nga Eagle Mobile.

Vodafone ka përfunduar kontratën me Repartin Ushtarak pas kërkesës së parë nga Eagle Mobile për të njëjtat numra të cilët më pas janë caktivizuar nga Vodafone.

Vodafone pretendon se ka vepruar në përputhje me nenin 15/2/c/cc, të Rregullores së Portabilitetit për refuzimin e portimit të numrave me arsyetimin se “Numri i cili do të bartet nuk është subjekt i një kontrate aktive”.

Kontrata mes Repartit Ushtarak 1040/1050 dhe Vodafone ka qenë aktive sepse abonenti nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës, dërsa Vodafone nuk ka plotësuar afatet ligjore dhe proceduriale për zgjidhjen e kontratës.

Shkresa e drejtuar për Eagle Mobile nga Reparti 1040 dhe Reparti 1050, konfirmon se njoftimi i vetëm me shkrim për zgjidhje kontrate i kryer nga Vodafone ka qenë ai i datës 07.07.2012, mbërritur në repart në datë 10.07.2012 (e shtunë), ku shprehet se në rast mos shlyerje të detyrimeve, Vodafone do të zgjidh kontratën brënda 5 ditëve nga marrja e njoftimit (data 15.07.2012).

Vodafone zgjidhjen e kontratës nuk e ka bër me datë 15.07.2012 sic ishte shprehur por në datë 12.07.2012 pra vetëm 2 ditë pas njoftimit të parë dhe të vetëm për zgjidhje kontrate. Sipas kontratës kërkohej njoftim paraprak me shkrim për ndërprerje të përkohëshme dhe pasi të kalonte afati 2 mujor nga ndërprerja Vodafone mund të zgjidhte kontratën.

2. Arsyeja e refuzimit “*Number not located in donor operator*” nuk mund të jepej nga Vodafone pasi nuk kemi plotësim të afateve ligjore për ndërprerjen përfundimtare të shërbimit.

Eagle Mobile i ka kërkuar Vodafone se në zbatim të Rregullores së Poratbilitetit të bashkëpunojë për finalizimin me sukses të procesit ,duke dokumentuar se Reparti 1040 dhe 1050 kan varësi nga Reparti 1001, i cili është portuar me sukses në datë 13.07.2012.

Vodafone pretendon se nuk ka ndërprer procesin e bartjes. Ai thot se duke qënë se pajtimtari mund të kërkojë bartjen e një pjese të numrave të tij drejt një operatori tjetër, pajtimtari mbetet klient i operatorit dhënë për ato numra që nuk kanë qënë subjekt i kërkesës për bartje, deri në momentin që vjen një i tillë.

Eagle Mobile i ka vënë në dispozicion Vodafone, autorizimin për portimin e të gjithë numrave të strukturave në varësi të repartit 1001 nga rrjeti Vodafone drejt rrjetit Eagle Mobile. Numrat i përkasin të njëjtit institucion, janë brenda së njëjtës kontratë, kanë një plan tarifor specifik si grup i vecantë dhe ligjërisht përfaqësohen nga i njëjti përfaqësues.

Duke qen se mes Repartit 1001 dhe Eagle Mobile është lidhur vetëm një kontratë. Për këtë arsye procesi i portimit duhet të vazhdojë si një i tërë dhe të mos ndërpritej në kundërshtim me Rregulloren e Portabilitetit për arsye të detyrimeve kontraktore, duke lënë pa shpërblim dhe dëmtuar së pari pajtimtarët.

Eagle Mobile e ka ndarë procesin e portimit në disa kërkesa, sepse sistemi nuk përballon më shumë se 600 numra në ditë dhe nëse do të ishte teknikisht e mundur të gjithë numrat do të kërkoreshin të portoheshin me të njëjtën kërkesë brenda një dite.

Eagle Mobile ka konstatuar se Vodafone ka vonuar procesin dhe për arsyen “NIPT does not match ëith donor database” pasi ky i fundit i ka regjistruar këto subjekte me NIPT të ndryshëm nga NIPT-i i regjistruar në të dhënat e veta. Për këtë arsye procesi vonohet sic është vonuar në rastin konkret, pasi operatori marrës nuk ka asnjë mënyre sesi të ketë dijëni mbi NIPT-in që Vodafone regjistron në të dhënat e tij subjektet.

3. Në përfundim, Eagle Mobile i kërkon AKEP, që:

- Lëshimin e Urdhrit me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP për detyrimin e Vodafone Albania për portimin e të gjithë numrave të repartit ushtarak 1040 dhe 1050 për të cilët Vodafone Albania ka patur një kontratë aktive deri më 11.07.2012, datë në të cilën është bërë kërkesa e Eagle Mobile për portimin e numrave të këtyre reparteve.
- Kompensim i dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar që i është shkaktuar Eagle Mobile si pasojë e kësaj mosmarrëveshjeje.

III. AKEP me shkresën nr.1594/7Prot., datë 31.10.2012 ka ftuar palet ne kryerjen e nje seance degjimore me datë 5.11.2012. Me kerkesën e palës ankimuese Eagle Mobile, me

shkresë nr.2019 Prot., datë 5.11.2012 (referenca e EM) seanca dëgjimore u krye më datë 12.11.2012, në selinë e AKEP. Të pranishëm ishin përfaqësues të të dyja palëve Eagle Mobile dhe Vodafone Albania. Edhe në këtë takim palët mbajtën të njëjtat qendrimë në lidhje me çështjen si në pretendimet përfundimtare të depozituara në AKEP.

III. AKEP, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet sa më sipër, gjykon se:

Sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. gjenden në një mosmarrëveshje mes tyre e cila buron nga kërkesa e pajtimtarit (repartit ushtarak 1040 dhe 1050) drejtuar sipërmarrësit Eagle Mobile për të lidhur kontratë për bartje të numrave mobile të caktuar nga Vodafone sh.a. dhe refuzimit të vazhdueshëm të këtij të fundit.

Referuar objektit të mosmarrëveshjes i cili gjen rregullim në dispozitat normative të rregullores nr. 13 date 16.04.2010 “ Për portabilitetin e Numrit” palët kanë vepruar me njëra – tjetrën duke interpretuar përcaktimet e rregullores së portabilitetit dhe kushteve të përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme të miratuara nga AKEP për Vodafone Albania sh.a.

1. Mosmarrëveshja e krijuar lidhet me interpretimin e palëve të datës së përfundimit të kontratës aktive, bazuar në njoftimin e Vodafone për ndërprerje kontrate të nisur nga Vodafone në adresë të dy reparteve ushtarake më datë 7.07.2012.
2. Vihet re se Vodafone sh.a, ka arsyetuar refuzimin e bere ndaj barjen e numrave nën interpretimin ligjor dhe rregullator se në cilësinë e “Operatorit dhënës” nuk ka qenë i detyruar të eksportojë numrat e alokuara repartit ushtarak 1040 dhe 1050 pasi dy kontratat për këto numra kishin përfunduar dhe numrat ishin tashme çaktivizuar përgjithmonë.

Vodafone ka njoftuar pajtimtarin e tij (Repartit 1050 dhe 1040) për ndërprerje të shërbimit të kontraktuar më dt. 30 dhe 31.07.2010 (kontratat respektive mes paleve) në rast të moskryerjes së pagesave sipas faturimit të detyrimeve kontraktuale brenda 5 ditëve nga marrja dijani e njoftimit, por në fakt nga administrimi i provave shkresore të paraqitura si dokumente nga ankimesi për AKEP rezultoi se definitivisht kjo ndërprerje është kryer me dt.12.07.2012 dhe jo më dt.15.07.2012 si datë që përkon me afatin maksimal për shlyerjen e detyrimeve nga pajtimtari debitor nëse do të respektohej afati procedural “diskrecional” i komunikuar dhe vetpërcaktuar nga Vodafone Albania sh.a.

3. Eagle Mobile në ankimin e tij ka përdorur komunikimet e Vodafone me dy repartet ushtarake, dhe veprimet që ka ndërmarrë Vodafone me pajtimtarët për ndërprerje të shërbimit për shkak të mospagesës së detyrimeve. Këto marrëdhënie, Vodafone-Pajtimtar, mbulohen nga kontrata e lidhur midis Vodafone dhe pajtimtarëve respektive, dhe cdo veprim i Vodafone ndaj pajtimtarit, përfshirë masën e shkëputjes së kontratës dhe interpretimi se kur kontrata konsiderohet e zgjidhur/jo-aktive, mund të ankimohet nga pajtimtari sipas nenit 14, germa ‘m’ e kontratës së Vodafone me pajtimtarin. Pra, për cdo rast të ndërprerjes së një kontrate të lidhur mes këtyre palëve, legjitimohet pala Pajtimtar për të kërkuar vendosjen në vend të së drejtës së cënuar ose të pretenduar të tillë. Në këtë rast pajtimtari (Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050) konstatohet në mos-ushttrim të së drejtës së tij ankimese kundrejt palës tjetër kontratore, në cilësinë e

ofruesit të shërbimit, si për shumën e detyrimit të papaguar dhe për njoftimin/veprimin e ndërprerjes së kontratës. Ky mosveprim i pajtimtarit i ka krijuar hapësira Vodafone të ndërmarrë veprime penalizuese paraparake të cilat kanë cuar dhe në masën finale të ndërprerjes së kontratës.

4. Për sa më sipër, AKEP vlerëson se zgjidhja e mosmarrëveshjes së portimit midis EM dhe Vodafone lidhet ngushtësisht me zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi kontratën e lidhur dhe nënshkruar nga palët pajtimtar (Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050)-Vodafone me objekt ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme. Në këtë mënyrë qëndrimi i AKEP konsiston që pajtimtari të ushtrojë të drejtën e tij të ankimit për veprimet e Vodafone dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mirëkuptim me palën Vodafone ose në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve të kontratës së lidhur.
5. Ndërkohë, referuar në praktikën e Vodafone me pajtimtarët, Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050, vihet re se:
 - a. Vodafone në mënyrë diskrecionale e gjendur në mirëbesim e ka vazhduar ofrimin e shërbimit edhe në kushtet e tejkalimit të afateve me qëllim mbrojtjen e interesit të përdoruesit për të përfituar nga shërbimet e ofruara.
 - b. Vodafone pas masës së ndërprerjes së kontratës ka vijuar kërkesën e përmbushjes së detyrimeve në rrugë gjyqësore me pajtimtarët për përmbushjen e detyrimeve të palikuajduara;

Në këto kushte Vodafone, megjithëse nuk ka më kontratë aktive me pajtimtarët e cituar, por pajtimtarët (megjithëse kanë kaluar 5 muaj) kanë ende interesin për të mbajtur këto numra të Vodafone duke i portuar në EM, ndërsa po ndjek në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimeve financiare, mund të aplikojë të drejtën diskrecionale për të respektuar interesin e vazhdueshëm të pajtimtarëve për të ruajtur numrin celular të alokuar nga Vodafone duke e portuar në një rrjet tjetër.

6. Sa i përket paragrafit të dytë në objektin e kërimit të sipërmarrësit ankimues Eagle Mobile të paraqitur në kërkesën ankimore nr. 1455/2 datë 02.08.2012 (të hartuar sipas formës së kërkuar nga AKEP) lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar që i është shkaktuar Eagle Mobile si pasojë e kësaj mosmarrëveshjeje, AKEP vlerëson kërkesën në tejkalim të kompetencës së tij lëndore administrative bazuar në kuadrin ligjor material mbi të cili ushtron recurs.
7. Përfundimisht, duke patur parasysh faktet e cituara dhe bazën ligjore referuese del qartë se mosmarrëveshja midis palëve është komplekse dhe e dyfishtë. Nga njera anë është marrëdhënia kontraktuale midis pajtimtarit (Repartit ushtarak) dhe sipërmarrësit Vodafone Albania e rregulluar mbi bazën e dispozitave të përcaktuara në kontratën e pajtimit të miratuar nga AKEP-i sipas nenit 99 të ligjit nr. 9918. Nga ana tjetër qëndron marrëdhënia midis sipërmarrësve Vodafone Albania dhe Eagle Mobile për ofrimin e shërbimit të portabilitetit të numrit sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren përkatëse të nxjerrë nga AKEP-i (Rregullore Nr. 13), si dhe e drejta e pa cënueshme e pajtimtarit për portimin e numrit, e sanksionuar në ligjin nr. 9918 dhe këtë rregullore. Por e drejta e portimit të numrit për pajtimtarin dhe ofrimi i shërbimit të portimit të numrit mbi bazën e kërkesës së pajtimtarit janë rrjedhoja të marrëdhënies së krijuar midis vetë

pajtimtarit dhe sipërmarrësit me të cilin pajtimtari ka lidhur kontratën e pajtimit. Në kushtet kur marrëdhënia midis pajtimtarit dhe sipërmarrësit është ndërprerë për shkak të vendimit të marrë nga sipërmarrësi për mosshlyerje detyrimesh financiare, kjo përbën një ngjarje juridike të cilën nëse pajtimtari e konsideron të parregullt ligjërisht dhe në kundërshtim me kushtet e kontratës së pajtimit, duhet ta ankimojë veprimin e sipërmarrësit sipas procedurës së përcaktuar në nenin 107 të ligjit nr. 9918. Sipas pikës 5 të nenit 107 të ligjit 9918, pajtimtarët kanë të drejtë që, në përputhje me përcaktimet në kontratë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ankohen në gjykatë për vendimin e marrë nga sipërmarrësi. Vendimi i gjykatës në rastin konkret do t'i jepte zgjidhjen përfundimtare qëndrimeve të mbajtura nga palët e interesuara në interpretim të dispozitave ligjore dhe fakteve e rrethanave të çështjes lidhur me atë që përbën thelbin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes edhe për të konsideruar statusin e pajtimtarin në raport me sipërmarrësin Vodafone Albania, në momentin e kërkesës së paraqitur për portimin e numrit tek sipërmarrësi Eagle Mobile. Pra duhet zgjidhur përfundimisht kjo çështje, nëse pajtimtari ka qenë ende i lidhur juridikisht me sipërmarrësin Vodafone Albania sipas kontratës së lidhur midis tyre, në momentin e paraqitjes së kërkesës për portimin e numrit, apo jo, e më pas për rrjedhojë merr përgjigjen e bazuar edhe kërkesa e sipërmarrësit Eagle Mobile sipas këtij ankimi.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012, *“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”*
2. Te refuzojë ankimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. për sa kohë nuk ka një qëndrim përfundimtar të shprehur nga Gjykata si organi kompetent sipas nenit 107 të ligjit nr. 9918, lidhur me ligjshmerinë e veprimit të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për zgjidhjen në mënyrë të njehshme të kontratës me pajtimtarin.
3. Të njoftohen palët e interesuara Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**